




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr Prot. Br Prot. 01-1118/14
Nr. i faq. Broj stranica 03	Data Datum 24.03.2014
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	24.03.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Ymer DRAGUSHA Drejtor i Zyrës Ekzekutive të Prokurimit në Korporatën Energjetike të Kosovës Sh.a
CC:	z. Arben GJUKAJ Drejtor Menaxhues në Korporatën Energjetike të Kosovës Sh.a
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull “ Riparimi kapital i Kaldajës dhe Qarqeve rregulluese njësia A5 Tc Kosova A ”



I nderuari, z. DRAGUSHA,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin “ Riparimi kapital i kaldajës dhe Qarqeve rregulluese njësia A5 Tc Kosova A ” me nr. të prokurimit: KEK-C 14-063-511, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejshme A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin “Riparimi kapital i kaldajës dhe Qarqeve rregulluese njësia A5 Tc Kosova A” në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Korporata Energjetike e Kosovës, përmes Zyrës Ekzekutive të Prokurimit ka përgatitë “Njoftimin për Kontratë” me titull “Riparimi kapital i kaldajës dhe Qarqeve rregulluese njësia A5 Tc Kosova A” me nr. të Prokurimit: KEK-C 14-063-511, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.21.02.2014 (Vazhdim i afatit të fundit për dorëzimin e ofertave), në Procedurë të Hapur. Agjencia kundër Korrupsionit, përmes Divizionit për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë procedurë të prokurimit si rast për trajtim. Gjatë trajtimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit për këtë aktivitet të prokurimit në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Në “Njoftimin për Kontratë” i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, me datë 21.02.2014 dhe “Dosjen e Tenderit”, tek rubrika III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar për Lot 1 është kërkuar Qarkullimi minimal në **2 vitet e fundit (2012,2013)** dhe atë për secilin vit minimum **4.000.000,00€ (për dy vitet 8,000.000.00 €)** të dëshmohet përmes raporteve bankare, pikë kjo e cila konsiderojmë se bie ndesh me Legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Në përcaktimin e Qarkullimit minimal, autoriteti kontraktues nuk duhet të kalojnë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës, përveç në raste të justifikuara, siç bëjnë ndaj rreziqeve të veçanta që lidhen me natyrën e punëve, shërbimeve ose furnizimeve të ofruara. Autoriteti kontraktues do t'i specifikojë rrethanat e tilla të jashtëzakonshme në dokumentet e tenderit. Kërkesat për qarkullim duhet të shprehen detyrimisht në shifra dhe do t'i referohen maksimum tri viteve të fundit financiare të përfunduara nga data e publikimit të njoftimit të kontratës. Vitet e tilla financiare do të tregohen shprehimisht në Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

Tek rubrika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, Autoriteti Kontraktues për Lot.1 ka kërkuar Listën e Referencave të realizimit të projekteve të ngjashme në riparimin dhe remonte të kaldajave, të kryera në **4 vjetët e fundit**, minimum 2 (dy) referenca si lider (nëse realizimi i kontratës është bërë nga konzorciumi). Të dëshmohet me kontratë dhe me Referencë të lëshuar nga punëdhënësi për kryerjen me sukses të remontit. Në rast konzorciumi referencat duhet të jenë në emër të liderit të grupit. Sipas Legjislacionit në fuqi për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues mundet të kërkojë një listë që specifikon secilin nga projektet punuese të OE dhe aktivitetëve të ndërtimit të kryera nga OE në 3 vitet e fundit të përcjellë me certifikatë të ekzekutimit të mirë që tregojnë vlerën, datën, llojin dhe vendin e projektit punues ose aktivitetëve të ndërtimit, por nuk i lejohet në asnjë mënyrë që ta kalojë këtë kufizim prej 3 viteve.

Gjatë krahasimit dhe ekzaminimit të dokumenteve të Dosjes së Tenderit, tek Specifikimet teknike faqe 8 është konstatuar se Njësia e kërkuese i ka propozuar gjithashtu edhe kriteret e përzgjedhjes e që është në kundërshtim me Legjislacionin në fuqi për prokurimin publik. Me Legjislacionin e Prokurimit Publik i cili është i zbatueshëm në Republikën e Kosovës, përcaktohen qartë funksionet e Njesisë së kërkesës dhe funksionet e Njesisë së Prokurimit, andaj se cila duhet vepruë konform funksioneve dhe përgjegjësi që ka.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin **68** Gjendja Ekonomike dhe Financiare, nenin **69** Aftësia Teknike dhe Profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, nenin **9** Funksionet e Njesisë së Kërkesës, nenin **10** Funksionet e Njesisë së Prokurimit dhe nenin **23** Kriteret e përzgjedhjes të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, dhe nenin **5** Gjendja ekonomike dhe Financiare e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2014 të KRPP-së

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!

